



The Danish  
Neighbourhood  
Programme



**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



# Udhëzuesi për Aplikantët

**Skema e Grantit “SARED” për Mbështetjen e  
Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik Bujqësor të  
Zonave Rurale të Pafavorizuara në Shqipëri**

March 2016

Versioni 3.0

## Tabela e Përbajtjes

1.	Skema e Grantit SARED.....	3
1.1	Hyrje .....	3
1.2	Përkufizimet Kryesore .....	4
1.3	Objektivat e Përgjithshme të Skemës së Grantit SARED .....	5
2-	Zinxhirët e Vleres, sektorët dhe përfituesit e pranueshëm .....	5
2.1-	Investimet dhe Zinxhirët e pranueshëm të Vleres .....	5
2.2	Kriteret e pranueshmërisë për Aplikantët në tre Zinxhirët e Vleres .....	5
2.2.1	Kush mund të aplikojë? .....	5
2.2.2	Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me statusin, pronësinë dhe territorin ku aplikantët ushtrojnë aktivitetin.....	5
2.2.3	Kerkesat minimale ne lidhje me aktivitetin buqesor te pranueshem.....	7
2.2.4	Kritere të pranueshmërinë ne lidhje me detyrimet financiare për aplikantët .....	8
2.2.5	Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me investimet .....	8
2.3	Kushtet Financiare të Projekteve për Investime të Pranueshme.....	8
2.3.1	Minimumi dhe Maksimumi i investimeve të pranueshme .....	8
2.3.2	Intensiteti i ndihmes (Shuma maksimale e grantit) .....	8
2.3.3	Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti .....	9
2.3.4	Si paguhet Granti? .....	9
3.	Rregullat e Pranueshmërisë .....	9
3.1	Shpenzimet e pranueshme në kuadrin e 3 ZV-es.....	9
3.1.1	Shpenzimet (kostot) e pranueshme .....	9
3.2	Investime dhe Shpenzime të Papranueshme .....	11
4.	Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të investimeve të pranueshme.....	12
4.1	Zinxhiri i Vleres 1 – Ripërtypësit e Vegjël (Delet dhe Dhitë).....	12
4.1.1	Prodhimi / përpunimi / marketingu (Delet dhe Dhitë) .....	12
4.2	Zinxhiri i Vleres 2 – Pemët Frutore dhe Arorët.....	12
4.2.1	Prodhimi / përpunimi / marketingu .....	12
4.3	Zinxhiri i Vleres 3 – Bimët Mjekësore dhe Aromatike.....	13
4.3.1	Prodhimi, grumbullimi/përpunimi / marketingu i Bimëve Aromatike dhe Mjekësore .....	13
5.	Procedura e Aplikimit.....	13
5.1	Thirrja për aplikime .....	13
5.2	Përbajtja e dosjes se Aplikimit .....	13
5.3	Procedura për Dorëzimin e Aplikimeve .....	16
5.4	Renditja e Aplikimeve .....	17
6.	Shënime të rëndësishme në lidhje me pranueshmërinë/refuzimin e Aplikimeve .....	17
6.1	Refuzimi për gabime madhore .....	17
6.2	Ridorëzimi i dokumenteve për gabime të vogla .....	17
6.3	Raste të tjera.....	18
7.	Kontrollet në vend.....	18
7.1	Kontrolli në Vend para kontraktimit .....	18

7.2 Kontrolli në Vend para pagesës.....	18
8. Njoftimi i Aplikantëve në lidhje me marrjen e vendimit .....	19
9. Ankesat .....	19
10. Kontrata për dhënien e grantit .....	19
11. Vizibiliteti i investimit dhe kontrolllet pas financimit .....	19
12. Miratimi për Pagesën e Grantit – Kryerja e Pagesës.....	19
12.1 Dosjen e kërkesës për pagesë permban;.....	20
12.2 Kryerja e pageses.....	20
13. Përbledhje e disa Shënimave të Rëndësishme për Aplikantët .....	21

## **1. Skema e Grantit SARED**

### **1.1 Hyrje**

Programi Gjermano-Danez “Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në zonat e pafavorizuara në Shqipëri” – SARED është një program i financuar bashkërisht nga Qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë në përputhje me objektivin strategjik të Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural për Shqipërinë 2014 - 2020.

Kohëzgjatja e Programit është nga muaji qershor 2014 deri në muajin maj 2018.

Programi SARED ka për qëllim të rrisë qëndrueshmërinë ekonomike të zonave malore të disavantazhuara në mënyrë të tillë që të gjenerojë një ndikim me bazë të gjërë. Një nga përbërësit e SARED është zbatimi i investimeve për zhvillimin e sektorit agro-ushqimor dhe turizmit rural. Skema e Grantit bashkëfinancohet nga përfituesit.

Skema e Grantit SARED do të zbatohet nga GIZ-i (**Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)**) në bashkëpunim me MBZHRAU-n dhe do të operojë në Shqipëri në gjashtë qarqe, konkretisht në Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë, Elbasan dhe Berat.

Mbështetja e Skemës së Grantit SARED do të ofrohet në tre Zinxhirë të përzgjedhur Vlerash, të cilat janë 1) ripërtypësit e vegjël, 2) pemët frutore dhe arorët, 3) bimët aromatike dhe mjekësore.

**Buxheti total i Skemës së Grantit është **6,500,000 EURO**.**

Ky Udhëzues për Aplikantët përcakton rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen, kontraktimin, zbatimin e projekteve të investimeve, dorezimin e kerkeses per Pagesen e grantit, kontrollin ne vend dhe ekzekutimin e pageses sipas kërkesave të Skemës së Granteve në të tre Zinxhirët e Vleres që mbulojnë të gjitha hallkat që nga ferma deri tek përpunimi, marketingu dhe shërbimet.

Ky Udhëzues së bashku me të gjithë informacionin që lidhet me Thirrjen për Aplikime si edhe formatet e nevojshme per alikimin mund të merret në faqen e mëposhtme të internetit:

[www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al)

ose duke klikuar direkt mbi linkun me poshte:

<http://www.bujqesia.gov.al/al/programi/projekti-sared>

## 1.2 Përkufizimet Kryesore

- **UpA:** Udhezuesi per Aplikantet
- **Autoriteti Kontraktues:** GIZ / SARED
- **Aplicant:** është një fermer individual, një person fizik apo juridik, SHBB i cili dorëzon një aplikim për grant në përputhje me Thirrjen për Dorëzimin e Aplikimeve;
- **Përfitues** (ose përfitues i grantit): është një person fizik apo juridik, të cilat i është dhënë një grant për zbatimin e investimit (projektit).
- **Projekt investimi:** konsiston në një sërë aktivitetesh investimi në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme me synim përbushjen e objektivave të sektorëve që mbështet skema e grantit.
- **Grant:** është një pagesë nga Autoriteti Kontraktual për rimbursimin e një pjese të shpenzimeve të pranueshme të bëra nga përfituesi për projektin e investimit në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme.
- **Vendimi per dhenien e grantit dhe nenshkrimin e kontrates:** eshte vendimi qe merr autoriteti kontraktues per dhenien e grantit aplikuesit te sukseshmen mbi baze te kontrates qe nenshkruehet ndermjet tyre.
- **Vendimi per autorizimin dhe kryerjen e pageses se grantit:** eshte vendimi i autoritetit kontraktues qe autorizon sasine e grantit dhe kryerjen e pageses. Ky vendim merret pasi kerkesa per pagese qe paraqet aplikanti pasi ka zbatuar investimin eshte vleresuar pozitivisht.
- **Kontributi publik (SARED):** është shuma e kontributit financiar dhënë nga GIZ/SARED, e cila është e barabartë me 50% - 75% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit.
- **Kontributi i përfituesit:** është shuma e kontributit financiar dhënë nga përfituesi, e cila është e barabartë me 25% - 50% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit të investimit.
- **Shpenzime të pranueshme:** janë shpenzimet e aprovuara në përputhje me kërkuesat e Skemës së Grantit të përcaktuara në Aneksin 6 të këtij Udhëzuesi për Aplikantët.
- **Aplicant i ri:** aplikant nën moshën 40 vjeç në ditën e aplikimit.
- **Ndërmarrje:** subjekt juridik që mund të përbëhet nga një ose nga më shumë stabilimente (njësi lokale prodhimi/përpunimi).
- **Stabiliment:** njësi lokale prodhimi e paregjistuar si person juridik që i përket një ndërmarrjeje që plotëson kriteret për t'u mbështetur nga kjo skemë grantesh.
- **Rikonstruksion:** rinoim i një ndërtese/godine ekzistuese (pa përfshirë zgjerimet).
- **Ndërtim:** ndërtim i një ndërtese/godine të re të një ferme/sipërmarrjeje/stabilimenti bujqësor ekzistues.
- **Përpunim:** nënkuption hapat që përfshijnë grumbullimin dhe ruajtjen deri në produktin përfundimtar
- **Marketing:** nënkuption investime dhe aktivitete për promovimin e një produkti
- **Diversifikim ne kuader te 3 VC kondierohet;**
  - A. Cdo investim qe kryehet ne kuader te ZV 3 (MAPs)
  - B. Investimet e bera ne kuader te VC 1 (RV) dhe VC 2 (F&A) ne lidhje me;
    1. Perpunimin ne ferme dhe tregtimin e drejtperdrejte (me pakice) te produkteve bujqësore nen 3 ZV;
    2. Nje "Produkt te Ri" ne kuader te ZV 1 (RV) dhe ZV 2 (F&A)
      - **Produkt i Ri:**
        - i. **Ne kuader te ZV 1 (RV)** konsiderohet
          - Futja ne ferme e racave te reja me kapacitet te larte dhe / ose
          - Produkte te reja qe prodhohen nga perpunimi i qumeshtit te RV
        - ii. **Ne kuader te ZV 2 (F&A)** konsiderohet
          - Futja ne ferme e varieteteve te reja me kapacitet te larte dhe / ose
          - Produkte te reja qe prodhohen nga perpunimi i lendeve te para

### **1.3 Objektivat e Përgjithshme të Skemës së Grantit SARED**

Objektivat e përgjithshme të Skemës së Grantit për zhvillimin e sektorëve agro-ushqimor ne zonat rurale janë si më poshtë:

- Përmirësimi i performancës së përgjithshme dhe konkurrueshmërisë së prodhimit të produkteve bujqësore primare, si dhe të përpunimit dhe marketingut të tyre;
- Kontributi për rritjen e konkurrueshmërisë së zonave rurale shqiptare duke rritur kapacitetet e investimit dhe aftësinë perthithese te aktorëve ekonomikë në 3 Zinxhirët e Vleres;
- Te kontribuoje për përmirësimin gradual të fermave/stabilimenteve bujqësore në zonat rurale drejt plotesimit te standardeve kombëtare, kryesisht në fushat e sigurisë dhe cilësisë ushqimore, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të kafshëve dhe bimëve dhe te mbrojtjes mjedisore.,
- Te kontribuoje për zhvillimin e aktivitetit ekonomik te gjelber gradual të fermave/stabilimenteve bujqësore në zonat rurale nepermjet investimeve ne energjine e rinovueshme dhe ato qe mirembajne mjedisin.

## **2- Zinxhirët e Vleres, sektorët dhe përfituesit e pranueshëm**

### **2.1- Investimet dhe Zinxhirët e pranueshëm të Vleres**

SARED mbështet investimet në prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe marketingun e produkteve në këta **3 Zinxhirë te Vleres dhe nënsektorë të pranueshëm**:

#### **1- Në Zinxhirin e Vleres 1 – janë të pranueshëm këta nënsektorë;**

##### **Qumështi i Deles dhe Dhisë**

- investimet **në ferme** që mbështesin prodhimin, ruajtjen, përpunimin dhe marketingun.
- investimet **jashtë fermës** që mbështesin ndërmjetësit (grumbulluesit) dhe përpunuesit.

##### **Mishi i Dhenve dhe te Dhirtave**

- investimet **në ferme** që mbështesin prodhimin, ruajtjen, përpunimin dhe marketingun.

#### **2- Në Zinxhirin e Vleres 2 – Pemët Frutore dhe Arrore**

- investimet **në ferme** që mbështesin prodhimin, ruajtjen, përpunimin dhe marketingun.
- investimet **jashtë fermës** që mbështesin grumbulluesit, përpunuesit dhe marketingun.

#### **3- Në Zinxhirin e Vleres 3 – Bimët Aromatike dhe Mjekesore**

- investimet **në ferme** që mbështesin prodhimin, ruajtjen, përpunimin dhe marketingun.
- investimet **jashtë fermës** që mbështesin grumbulluesit, përpunuesit dhe marketingun.

### **2.2 Kriteret e pranueshmërisë për Aplikantët në tre Zinxhirët e Vleres**

#### **2.2.1 Kush mund të aplikojë?**

Skema është e hapur për aplikime nga fermerë individë, persona fizikë dhe persona juridikë përfshirë SHBB-të të cilët zotërojnë ose përfaqësojnë ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme dhe që aktualisht ushtrojnë një aktivitet ose që dëshirojnë të fillojnë një aktivitet (start up) në prodhimin, grumbullimin, përpunimin apo marketingun e produkteve bujqësore në kuadër të 3 Zinxhirëve të Vlerës të pranueshëm;

#### **2.2.2 Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me statusin, pronësinë dhe territorin ku aplikantët ushtrojnë aktivitetin**

**Për të qenë të pranueshëm, aplikantët duhet të plotësojnë këto kritere qe vijojne;**

- a. Të jenë fermerë individualë të regjistruar në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë përkatëse dhe te paisur me kartë të fermerit, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në

kuadër të 1 nga 3 ZV te pranueshem, dhe që mund të provojne pronësine e tokës dhe/ose ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti bujqesor me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shih kerkesat tek Formulari i Aplikimit – Aneksi 1 i UpA), **ose**

- b. Të jenë persona fizikë të regjistruar sipas legjislacionit kombëtar dhe të licencuar nëse e kërkon legjislacioni vendas për aktivitetin ekonomik në kuadër të 1 nga 3 ZV te pranueshem, dhe që mund të provojne pronësine e tokës dhe/ose ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti bujqesor me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shih kerkesat tek Formulari i Aplikimit – Aneksi 1 i UpA) **ose**
- c. Të jenë persona juridikë me pronësi 100% private dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin vendas në Regjistrin Kombëtar dhe të licencuar nëse e kërkon legjislacioni vendas për aktivitet ekonomik në kuadër të 1 nga 3 ZV te pranueshem, dhe që mund të provojne pronësine e tokës dhe/ose ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti bujqesor me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shih kerkesat tek Formulari i Aplikimit – Aneksi 1 i UpA) **ose**
- d. të pranueshëm janë Shoqëritë për Bashkëpunim Bujqësor të themeluara dhe të regjistruala në përputhje me legjislacionin vendas (Liqji Nr. 38/2012) në Regjistrin Kombëtar dhe të licencuara nëse e kërkon legjislacioni kombëtar, për aktivitetet ekonomik bujqësor në kuadër të 1 nga 3 ZV te pranueshem, dhe që mund të provojne pronësine e tokës dhe/ose ndërtesës ku ushtrohet aktiviteti bujqesor me dokumenta të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shih kerkesat tek Formulari i Aplikimit – Aneksi 1 i UpA) **ose**
- e. të pranueshëm janë edhe fermerët individë, personat fizikë dhe / ose personat juridikë dhe / ose Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor që kanë marrë me qira tokën dhe/ose ndërtesën për të paktën 5 vjet nepermjet një kontrate qeramarrje te noterizuar, për një aktivitet ose disa aktivitete ekonomike bujqësore të pranueshme (investime të pranueshme sipas UpA) në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe që mund të vërtetojnë pronësinë përmes dokumentacionit ligjor të lëshuar në përputhje me legjislacionin vendas (shih kerkesat tek Formulari i Aplikimit – Aneksi 1 i UpA). Kontrata e qiramarrjes duhet e noterizuar.
- f. Te pranueshem janë fermerët individë, personat fizike apo juridike dhe SHBB qe janë autorizuar te perdonin dhe investojne ne token apo ndertesen per te pakten 5 vjet pas dates se aplikimit per një investim te pranueshem per te cilin aplikon. Ai / Ata duhet te paraqesin “Kontraten e Huaperdorimit” te noterizuar dhe te shoqeruar me dokumentacionin e pronesise te leshuara sipas legjislacionit ne fuqi (shi kerkesat ne Aneksin 1 te UpA).
- g. Te pranueshem janë ata qe ushtrojnë aktivitetin e tij / tyre ekonomik të pranueshëm në territorin e 6 qarqeve (Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë, Elbasan dhe Berat) në përputhje me 1 nga 3 Zinxhirët e Vleres te pranueshem.
- h. Përjashtim nga rregulli i mësipërm do të bëhet për ata aktorë kryesorë të Zinxhirëve të Vleres 1-3 (grumbullues, përpunues), stabilimentet e të cilëve ndodhen jashtë këtij territori, por që 60% të sasise te lëndës së parë që ata përpunojnë/shesin si produkt final e marrin nga territoret e pranueshme. Këtë fakt aplikuesi duhet ta vërtetojë me dokumenta ligjore si psh bilanci, dhe me kontratat e blerjes së produkteve lëndë e parë për përpunim, me prodhuesit nga rajonet e pranueshem.
- i. Ata duhet të aplikojnë **vetëm për investime** në Zinxhirët e Vlerës 1-3 dhe të bazuar ne Listen e Investimeve / Shpenzimeve te Pranueshme (Aneksi 3 dhe 4 i UpA),
- j. Për të qenë i pranueshëm për investime në fermë për përpunimin / marketingun e produkteve bujqësore në kuadrin e 1 nga 3 ZV te pranueshem, aplikanti duhet të prodhojë te pakten 30% të lëndës së parë respektive në fermën e tij.
- k. Nje aplikant nuk mund të paraqesë një aplikim të ri përpara se t'ë ketë marrë pagesën përfundimtare për një kontratë të mëparshme granti në kuadër të SARED.

### 2.2.3 Kerkesat minimale ne lidhje me aktivitetin bujqesor te pranueshem

Aplikantët qe te jene te pranushem per investime **duhet** të përbushin **kërkесат минимале** në lidhje me aktiviteve bujqësore ekonomike ne kuader te 1 nga 3 ZV te pranueshem, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sic specifikohet në tabelën më poshtë:

Zinxhiri i Vlerës	Kërkесат минимале		
	Prodhim / marketing	Grumbullim / Përpunim / Marketing	Jashte Fermes
<b>ZV 1 - Ripërtypësit e Vegjël - Qumështi</b>			
Për investime në sektorin qumësh dele/dhie	në Ferme	në Ferme	Jashte Fermes
	Minimumi 30 dele dhe/ose dhi të të gjitha moshave dhe sekseve, të regjistruala në regjistrin e kafshëve të MBZHRAU <u>në kohën e aplikimit</u> .	Kapacitet minimal perpunimi 100 litra qumësh/ditë at the end of investment , por të paktën 30% e lëndës së parë të përpunuar duhet të prodhohet nga vetë aplikanti ne fermen e tij.	Kapacitet perpunues minimal 0,5 ton qumësh i përpunuar në ditë <u>në fund të investimit (para pagesës përfundimtare)</u> për njësitë/stabilimentet e grumbullimit ose përpunimit të qumështit.
<b>ZV 1 - Ripërtypësit e Vegjël - Mishi</b>			
Për investime në sektorin e mishit te dhenve/ dhirtave	në Ferme	në Ferme	Jashte Fermes
	Minimumi 30 dele dhe/ose dhi të të gjitha moshave dhe sekseve, të regjistruala në regjistrin e kafshëve të MBZHRAU <u>në kohën e aplikimit</u>	<b>Nuk ka kërkesa minimale</b>	<b>Nuk pranojnë aplikime</b>
<b>ZV 2 - Pemë Frutore dhe Arrore (F&amp;A)</b>			
Për investime në prodhimin e frutave dhe arroreve	në Ferme	në Ferme	Jashte Fermes
	Minimumi 0.2 ha tokë e kultivuar me peme frutore në një bllok <u>në fund të investimit (para pagesës përfundimtare)</u> .	Për përpunimin në nivel ferme të paktën 30% e lëndës së parë të përpunuar duhet të prodhohet nga vetë aplikanti ne fermen e tij.	<b>Nuk ka kërkesa minimale</b>
<b>ZV 3 - Bimët Aromatike dhe Mjekesore (BAMs)</b>			
Për investime në BAMs	në Ferme	në Ferme	Jashte fermes
	Minimumi 0.2 ha tokë e kultivuar me Bimë Mjekesore dhe Aromatike në një parcelë <u>në fund të investimit (perpara pageses)</u> .	Për përpunimin në nivel ferme të paktën 30% e lëndës së parë të përpunuar duhet të prodhohet nga vetë aplikanti ne fermen e tij.	<b>Nuk ka kërkesa minimale</b>

**Nje aplikant mund të aplikojë për investime përgjatë të njëjtit Zinxhir Vlerash duke përbushur kërkесат минимале respektive.**

## 2.2.4 Kriteret e pranueshmërinë ne lidhje me detyrimet financiare për aplikantët

### Aplikanti duhet:

- të ketë përmbushur detyrimet në lidhje me taksën mbi tokën, në rast se është një fermer individual.
- të ketë përmbushur të gjitha detyrimet financiare kundrejt shtetit siç ia kërkon ligji ne perputhje me statusin me te cilin aplikon dhe detyrimeve financiare ne lidhje me aktivitetin e tij ekonomik, persa i perket taksave / tatimeve, duke përfshirë taksën mbi tokën, taksën mbi pronën (ndërtesat) dhe të ketë paguar kontributet për sigurime shoqërore (sigurimet për pension dhe sigurimet shëndetësore), në rast se aplikanti është person fizik ose juridik dmth një operator biznesi privat ose SHBB **dhe**
- të mos ketë detyrime financiare të papaguara ndaj MBZHRAU dhe strukturave vartese te sal (perfshire AZHBR).
- Te mos kete perfituar grante publike (fonde) ne 5 vitet e fundit per te njejtat investime per te cilat aplikon ne SARED.

## 2.2.5 Kriteret e pranueshmërisë në lidhje me investimet

- Në përfundim të investimit ato duhet të janë në përputhje me standaret kombëtare në fushën përkatëse; atë të sigurisë ushqimore, të shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, të mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes mjedisore.,
- Në rastin e investimeve në energji të rinoqveshme (në nivel ferme), të pranueshme janë vetëm investimet për përdorim të energjisë që përftohet vetëm për aktivitetin vetjak bujqësor në fermë.
- Materiali mbjelles si farërat dhe/ose fidanet për frutat, arroret dhe/ose BAMs që do të përdoren duhet të janë të certifikuara, respektivisht te regjistruara nga ESHFF sipas legjislacionit kombëtar përkatës në fuqi.

## 2.3 Kushtet Financiare të Projekteve për Investime të Pranueshme

### 2.3.1 Minimumi dhe Maksimumi i investimeve të pranueshme

Në këtë kuadër, shpenzimet e pranueshme totale (shihni seksionin 3) për të cilat mund të kërkohet një grant, duhet të janë midis këtyre shumave minimale dhe maksimale të shpenzimeve/investimeve të pranueshme:

- shuma **minimale** e totalit te investimeve të pranueshme **në ferme**: 400,000 Lek
- shuma **minimale** e totalit te investimeve të pranueshme **në ferme**: 3,500,000 Lek
- shuma **minimale** e totalit te investimeve të pranueshme **jashte fermes**: 700,000 Lek
- shuma **minimale** e totalit te investimeve të pranueshme **jashte fermes**: 10,000,000 Lek

### 2.3.2 Intensiteti i ndihmes (Shuma maksimale e grantit)

Kujdes: Madhesia e vleres se grantit perllogaritet vetem mbi bazen e “shpenzimeve te pranueshme” (jo mbi madhesine e vleres se investimit). “Shpenzimet e papranueshme” nuk merren parasysh ne perllogaritjen e vleres se grantit.

- A. Për investimet **në ferme** në kuadrin e ZV 1-3, madhesia e grantit është nga 65% deri në 75% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit të pranueshëm të realizuar dhe te detajuar si vijon;
- **Madhesia bazë e grantit** për të gjithë përfituesit për investimet në nivel ferme është 65 % e totalit të shpenzimeve të pranueshme.
  - **Shumes baze te grantit prej 65% do t'i shtohet vlera prej 10 % e shpenzimeve të pranueshme të bera ne lidhje me** investimin e realizuar në lidhje me magazinimin dhe manovrimin trajtimin dhe asgjësimin e e plehut (ne blegtori), por edhe të mbetjeve të tjera që vijnë si rezultat i aktivitetit ekonomik bujqësor, duke respektuar standaret kombëtare të mbrojtjes së mjedisit.

**B. Për grumbulluesit dhe agro-përpunuesit (investimet jashtë ferme) në kuadrin e ZV 1-3, Madhesia e Grantit është 50% - 60% e shpenzimeve totale të pranueshme për investimin e pranueshëm të realizuar si vijon.**

- **Madhesia bazë e grantit për grumbulluesit dhe agro-përpunuesit është 50 % e shpenzimeve totale të pranueshme për investimin e pranueshëm të realizuar.**
- **Kësaj shume do t'i shtohet vlera prej 10 % e shpenzimeve të pranueshme te bera ne lidhje me investimin e pranueshëm të realizuar për menaxhimin e mbetjeve (trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve që vijnë si rezultat i aktivitetit ekonomik - përpunimit), **OSE** nëse investimi është realizuar nga një aplikant i ri në moshë (*individ apo përfaqësues ligjor i kompanisë private/shoqatës për bashkëpunim bujqësor*) **OSE** nëse investimi është realizuar nga një grua (*individ apo përfaqësues ligjor i kompanisë private/shoqatës për bashkëpunim bujqësor*).**

### **2.3.3 Kohëzgjatja e zbatimit të një projekti**

Afatet e realizimit te investimit dhe te paraqites se kerkeses per pagesen e grantit do të specifikohen në kontratat individuale të granteve qe nenshkuhen ndermjet Autoritetit Kontraktues (GIZ) dhe përfituesve potencialë. Kontrata e nenshkuar përmban edhe informacionin nese eshte e mundur por edhe se si veprohet ne rast te nevojes per shtyrjen e afateve te realizimit te investimit.

Data maksimale e mundeshme per zbatimit e një projekti investimi eshte data **31 janar 2018**, dhe Kërkesa për Pagesë duhet të dorëzohet maksimumi deri më **21 shkurt 2018**.

Pertej këtyre afateve të lartpermendura nuk do të ketë asnje shtyrje.

### **2.3.4 Si paguhet Granti?**

- Në kuadrin e skemës së grantit SARED" nuk bëhen pagesa paradhënie apo pagesa të ndërmjetme.
- Granti do të paguhet i gjithë njëherësh në përfundim të investimit të pranueshëm te kontraktuar.
- Pagesa do të bëhet ne baze te **kerkeses per pagesen e grantit** qe aplikanti e paraqet ne perfundim te realizimit te investimit siç parashikohet në kontratë. .Formulari i Kerkeses per Pagesë shkarkohet nga faqja e internetit e MBZHRAU.
- Formulari kerkeses per pagesen shkarkohet nga faqja web e MBZHRAU. [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al)

## **3. Rregullat e Pranueshmërisë**

### **3.1 Shpenzimet e pranueshme në kuadrin e 3 ZV-es**

Me poshte jane shpjeguar me ne detaje 2 kartegorite e shpenzimeve qe konsiderohen (i) te pranueshme dhe (ii) te papranueshme

Për të qenë të rimburueshme me ane te grantit, shpenzimet duhet të janë në përputhje me dispozitat e Kontratës së Grantit te nenshkuar ndermjet përfituesit dhe autoritetit kontraktues. Formati i kontrates se grantit qe i ofron aplikuesve informacion mbi permajtjen e saj është i publikuar në faqen e internetit të MBZHRAU:

#### **3.1.1 Shpenzimet (kostot) e pranueshme**

Për perllogaritjen e grantit do të merren parasysh vetëm "shpenzimet e pranueshme".

**Kostot (shpenzimet) e pranueshme** të bëra nga përfituesi **duhet të plotësojnë te gjitha kriteret që vijojnë:**

- të jenë kosto që jane te nevojshme per zbatimin e investimit te paraqitur në Listën e Shpenzimeve / Investimeve të Pranueshme (Aneksi 3 i UpA) dhe në buxhetin e detajuar të kontratës së grantit;
- të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme; çdo pagesë që lidhet me shpenzimet e pranueshme (si psh: blerje makinerish, punime ndërtimi, apo blerje shërbimesh këshillimore, etj) duhet të dokumentohet nga aplikanti nëpërmjet faturave të lëshuara nga furnitore apo ofrues te regjistruar të shërbimeve. Këto kosto duhet, veçanërisht ne rastin e personave fizike dhe ligjore, të mbahen në librat e llogarive të Përfituesit të Grantit qe jane të përcaktuara sipas standardeve në fuqi të Shqipërisë për mbajtjen e llogarive dhe sipas praktikave të zakonshme të ndjekura nga Përfituesi i Grantit për mbajtjen e kostove.
- të jenë të identifikueshme dhe te vertetueshme, te arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kriteret e menaxhimit të shëndoshë financiar, sidomos sa i përket ekonomicitetit dhe eficencës.
- të jenë kosto që lidhen me blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë edhe programet kompjuterike që shkojnë deri në vlerën e tregut të aseteve;
- është edhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)<sup>1</sup> për aplikantët që janë të regjistruar si fermerë individualë te regjistruar me NIPT ose karte fermeri.
- të jenë kosto që janë bërë dhe disbursuar gjatë periudhës së zbatimit të Projektit të Investimit (me përashtim të kostove të përgjithshme). Periudha e zbatimit dhe data e fillimit te saj do të parashikohet në kontratën e grantit midis aplikantit dhe Autoritetit Kontraktues: për këtë arsy, projekt i investimit nuk mund të fillojë dhe Përfituesit e Grantit nuk mund të lidhë kontrata dhe /ose te beje pagesa (transferta bankare) per furnitoret apo ofruesit e sherbimeve qe lidhen me zbatimin e projektit nenshkrimit te kontrates me autoritetin kontraktues.
- Te jenë kosto që lidhen me ndërtimin dhe rikonstruksionin / përmirësimin e pronave të paluajtshme. Ne kete rast;
  - a. Punimet e ndërtimit duhet të kryhen nga një palë e tretë e kontraktuar (person fizik ose juridik i regjistruar). Puna e vetë fermerit dhe e të afërmve të tij / punëtorëve të sipërmarrjes është kosto e papranueshme<sup>2</sup>.
  - b. Punimet e mirëmbajtjes rutinë të ndërtesave dhe godinave nuk janë të pranueshme. Mirëmbajtje rutinë do të thotë shërbime që kryhen sipas një plani sistematik dhe që kanë për qëllim të zgjasin jetën e përdorimit të një ndërtese dhe të reduktojnë nevojën për riparime madhore.
- Të jenë kosto të përgjithshme që lidhen me shpenzime që i referohen investimit dhe qe behen kryesisht per qellime te pergatitjes se dosjes se aplikimit dhe zbatimin e investimit, si:
  - a. pagesa per këshilluesit për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, përgatitja e planit të biznesit, kostot e përkthimit zyrtar të dokumenteve për dorëzimin e aplikimit, kostot e keshilltarit per ndjekjen dhe zbatimin e investimit të pranueshëm, duke përfshirë edhe përgatitjen e Kërkesës për Pagesë.
  - b. përgatitja e planit të projektit (projekti arkitekturor, projekt i ndërtimit, preventivi i shpenzimeve, projekti teknologjik, projekti elektrik, projekti inxhinierik) arkitektët, inxhinierët, topografet, dhe
  - c. kosto të tjera per konsulence për studime fizibiliteti, përgatitje të strategjive të marketingut që lidhen ngushtë me investimin,
  - d. kostot e marrjes se licencave,

**Shuma totale e kostove të përgjithshme të pranueshme** është deri në një tavan prej 12 % të shpenzimeve totale të pranueshme, duke përfshirë edhe kostot për përgatitjen e planit të

<sup>1</sup> Fermeret te cilet do te importojne direkt vete paisjet ose makinerite buqesore pa paguar TVSH duhet ta deklarojne kete fakt ne formularin e aplikimit dhe duhet te respektojne procedure qe percaktohet ne Ligjin Nr 92/2014 te dates 24/07/2014 dhe ne VKM Nr 13 date 14/02/2015

<sup>2</sup> Kontrolloni tek pika mbi kostot e pranueshme se çfarë “kontributi në natyrë është i pranueshëm”.

biznesit deri në një tavan prej 4 % të shpenzimeve totale të pranueshme. Keto shpenzime duhet te vertetohen me fature origjinale te leshuar nga ofruesit e sherbimit, te rregjistruar sipas legjisacionit Shqiptar.

### 3.2 Investime dhe Shpenzime të Papranueshme

Në kuadrin e të 3 Zinxhirëve të Vlerave, **investimet /shpenzimet e mëposhteme** nuk do të merren parasysh ne perllogaritjen e mases se grantit:

- Projektet ku produksi përfundimtar nuk është në listën e shpenzimeve të pranueshme paraqitur në Aneksin 3;
- Projektet/investimet e finançuara nga burime të tjera publike për të njëjtat investime;
- Projekte thjesht kërkimore/studimore;
- Projekte që lidhen me përpunimin dhe marketingun e produkteve, të cilat imitojnë apo zëvendësojnë produktet bujqësore primare në Zinxhirët e Vleres 1-3 (p.sh. qumështin dhe produktet e qumështit);
- Projekte për zëvendësimin e objekteve, paisjeve të finançuara nga grante të tjera në 5 vitet e mëparshme;
- Projekte që kanë filluar para nenshkrimit te kontrates me autoritetin kontraktues;
- Puna e aplikantit dhe ajo e punëtorëve dhe të afërmve të tij për projektin;
- Punimet e mirëmbajtjes rutinë të ndërtesave dhe godinave nuk janë të pranueshme. Mirëmbajtje rutinë do të thotë shërbime që kryhen sipas një plani sistematik dhe që kanë për qëllim të zgjasin jetën e përdorimit të një ndërtese dhe të reduktojnë nevojën përiparime madhore;
- Blerja, marrja me qera apo leasing e tokës dhe godinave ekzistuese dhe marrja me qera/leasing e makinerive / paisjeve bujqësore;
- Blerja, marrja apo leasing e kafshëve;
- Blerja e bimëve një-vjeçare dhe mbjellja e tyre;
- Kostot e operimit (si mallrat e konsumit, shërbimet dhe furnizimi me karburant – energji elektrike, ujë, naftë, gaz, etj.), kostot e mirëmbajtjes, amortizimit dhe qirasë;
- Të gjitha llojet e kontributeve në natyrë;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për aplikantët që janë regjistruar si persona fizike ose juridike;
- Taksa te tjera;
- Tarifat doganore dhe të importit dhe çdo detyrim tjetër;
- Kostot e këmbimit te monedhes, detyrimet dhe humbjet nga këmbimi valutor, si dhe shpenzimet e tjera thjesht financiare;
- Leasing-u, marzhet e qiradhënësve, kostot e rifinancimit të interesave, tarifat e sigurimeve dhe shpenzimet administrative shtesë (*overheads*);
- Çdo kosto e ngarkuar nga administrata publike në menaxhimin dhe dhenien e sherbimeve;
- Blerja e pajisjeve të përdorura;
- Shpenzimet e bëra para nënshkrimit të kontratës së Grantit me përjashtim të kostove të përgjithshme siç përcaktohen në seksionin 3.1;
- Gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e proceseve gjyqësore;
- Detyrimet bankare, kostot e garancive dhe detyrimet e ngjashme;
- Borxhet dhe përqindjet e interesave të borxheve nga humbjet ose detyrimet potenciale të ardhshme;
- Interesat që janë për t'u paguar;
- Kostot e të njëjit investim të mbuluara nga një tjetër projekt i finançuar nga një program kombëtar apo donator.

#### **4. Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë të investimeve të pranueshme**

Ju lutemi, referojuni Aneksit 3 te UpA, ku jepen detajet të investimeve që janë të pranueshme në kuadrin e kësaj Skeme grantesh.

Një aplikim mund të përmbushe **një ose më shumë objektiva** të një Zinxhiri Vlere dhe të **përfshijë një ose më shumë lloje investimi brenda te njejtë zinxhir vlere** të renditur në Aneksin 3 - Lista e Shpenzimeve te Pranueshme të Udhëzuesit për Aplikantët të skemës së granteve SARED.

#### **Objektivat e përgjithshme të skemës së granteve SARED**

Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së fermave bujqësore, stabilimenteve agro-përpunuese dhe turizmit rural;

Te kontribuoje për zhvillimin e aktivitetit ekonomik te gjelber të fermave/stabilimenteve bujqësore në zonat rurale nepermjet investimeve ne energjine e rinovueshme dhe ato qe mirembajne mjedisin.

Modernizimi i prodhimit, përpunimit të produkteve bujqësore në përputhje me kërkuesat ligjore kombëtare, përkatesisht standartet në fushat e mbrojtjes/ruajtjes mjedisore, sigurisë dhe cilësisë ushqimore, shëndetit të bimëve dhe shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.

##### **4.1 Zinxhiri i Vleres 1 – Ripërtypësit e Vegjël (Delet dhe Dhitë)**

###### **4.1.1 Prodhimi / përpunimi / marketingu (Delet dhe Dhitë)**

Të pranueshme për mbështetje janë projektet e investimit me këto objektiva:

- Rritja e prodhimit dhe cilësisë së qumështit në nivel ferme përmirësimit të kushteve te mbareshimit, te strehimit, të teknikave të ushqyerit, prodhimit të ushqimit per blektorine, teknologjine e prodhimit te qumeshtit e mishit nga dhente e dhite, permiresimin e mijeljes dhe te higjenes etj.;
- Përmirësimi i kushteve të higjenës dhe cilësisë së qumështit të papërpunuar në nivel ferme përmes modernizimit të prodhimit, ruajtjes në pikat e grumbullimit të qumështit dhe teknologjive dhe praktikave të transportit;
- Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve përmes investimeve në strehimin e kafshëve dhe në mënyrën e manovrimit;
- Futjes së mënyrave të manovrimit, ruajtjes dhe trajtimit të plehut miqësore me mjedisin;
- Nxitja e futjes së teknologjive dhe praktikave në njësitë/ndërmarrjet e përpunimit të qumështit që kontribuojnë në prodhimin e produkteve të bulmetit që plotësojnë standartet kombëtare dhe që përmirësojnë konkurrueshmërinë;
- Mbështetja e futjes së sistemeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore;
- Përmirësimi i trajtimit dhe manovrimit të mbetjeve.
- Futja graduale e elementeve te ekonomise se gjelber nepermjet investimeve ne enerġjine e rinovueshme dhe ato qe mireruajne mjedisin.

##### **4.2 Zinxhiri i Vleres 2 – Pemët Frutore dhe Arorët**

###### **4.2.1 Prodhimi / përpunimi / marketingu**

Të pranueshme për mbështetje janë projektet e investimit që kanë këto objektiva specifike:

- Përmirësimin e teknikave dhe teknologjisë së prodhimit dhe përpunimit, si dhe prodhimin e certifikuar të fidanëve për t'u dhënë mundësi fermerëve që të prodrojnë fruta arrore të një cilësie që mund të konkurrojë në tregun shqiptar që po ndryshon shumë shpejt;
- Përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të frutave dhe arroreve për përmirësimin e përgjithshëm të standardeve minimale përkatëse në fuqi në Shqipëri dhe sidomos në fushën e ruajtjes dhe aplikimit të kimikateve dhe plehëruesve të mbrojtjes së të korrave dhe në nivelet e mbetjeve kimike;

- Uljen e humbjeve pas korrjeve përmes investimeve në nivel ferme në teknologjinë dhe infrastrukturën e ruajtjes dhe pajisjeve të manovrimit pas vjetes, duke përfshirë kapacitetet ftohëse, përgjedhëse dhe linjat e paketimit;
- Mbështetjen e futjes së sistemeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore;
- Përmirësimin e marketingut të produkteve të përpunuara të frutave; në veçanti adresimin e problemit të kostove të larta të materialit paketues.
- Futja graduale e elementeve te ekonomise se gjelber nepermjet investimeve ne enerqjine e rinovueshme dhe ato qe mireruajne mjedisin.

#### **4.3 Zinxhiri i Vleres 3 – Bimët Mjekësore dhe Aromatike**

##### **4.3.1 Prodhimi, grumbullimi/përpunimi / marketingu i Bimëve Aromatike dhe Mjekesore**

Të pranueshme për mbështetje janë projektet e investimeve që kanë këto objektiva specifike:

- Përmirësimi i teknikave dhe teknologjisë së prodhimit dhe përpunimit, si dhe prodhimit të certifikuar të fidanëve për t'u dhënë mundësi fermerëve, grumbulluesve dhe perpunuesve që të prodhojnë Bimë Aromatike dhe Mjekesore të një cilësie që mund të konkurrojë në tregjet shqiptare dhe të huaja (eksportet) kërkuese dhe që ndryshojnë shumë shpejt;
- Përmirësimi i teknologjisë së prodhimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekesore për përmirësimin e përgjithshëm të standardeve përkatëse minimale të zbatueshme për tregjet ndërkombëtare dhe sidomos në ruajtjen dhe aplikimin e mbrojtjes, kimikateve dhe përdorimit të plehëruesve për Bimët Aromatike dhe Mjekesore, si dhe për nivelet e mbetjeve kimike;
- Reduktimi i humbjeve pas vjetes përmes investimeve në nivel ferme në teknologjinë dhe infrastrukturën e ruajtjes dhe në pajisjet për manovrimin pas vjetes, për seleksionimin dhe për linjat e paketimit;
- Mbështetja e futjes së sistemeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore;
- Përmirësimi i marketingut të produkteve të përpunuara të Bimëve Aromatike dhe Mjekesore që adresojnë kostot që lidhen me materialet e paketimit, etj.
- Futja graduale e elementeve te ekonomise se gjelber nepermjet investimeve ne enerqjine e rinovueshme dhe ato qe mireruajne mjedisin.

### **5. Procedura e Aplikimit**

#### **5.1 Thirrja për aplikime**

Aplikantët do të ftohen për të paraqitur aplikimet e tyre përmes një thirrje të hapur për aplikime, e cila do të bëhet publike përmes njoftimeve të publikuara në mediat kombëtare dhe rajonale dhe në faqen e internetit të MBZHRAU-t [www.bujgesia.gov.al](http://www.bujgesia.gov.al)

Kujdes, informacioni i sakte mbi thirrjet per aplikime, kohezgjatjen e sejçiles nga thirrjet per aplikime si edhe afatet brenda të cilave mund të paraqiten aplikimet do te percaktohen në **njoftimin per thirrjen për aplikime** do të publikohet ne gazetat kombetare por do te puiblikohet edhe ne faqen e internetit te MBZHRAU [www.bujgesia.gov.al](http://www.bujgesia.gov.al).

Ne kuader zbatimit te skemes se granteve SARED data me e fundit e pranimit te aplikimeve do te jete 30 shtatori i vitit 2017 ose data kur kane perfunduar fondet e skemes se granteve SARED.

#### **5.2 Përbajtja e dosjes se Aplikimit**

**Dosja e aplikimit duhet te jete e tera ne gjuhen shqipe**, respektivisht perkthyer ne shqip. Ne rastin kur dokumentat mbështetes si psh. ofertat, fakturat etj nuk jane ne gjuhen shqipe

(furnitoret nga jashtë vendit) atehere behet një perkthim zyrtar ne gjuhen Shqipe dhe i bashkengjitet dokumentit origjinal.

Aplikantët duhet të paraqesin dosjen e Aplikimit që përmban:

- (a) Formularin e aplikimit,** (Aneksi 1 i UpA)
- (b) Planin e Biznesit** dhe
- (c) Të gjitha dokumentet mbështetëse,** siç kërkon në formularin e Aplikimit.

**(a) Formulari i Aplikimit – Aneksi 1.** Ju lutemi paraqisni formularin e aplikimit në **version të plotesuar ne kompjuter dhe te printuar origjinal dhe te firmosur nga aplikuesi.**

**(b) Plani i Biznesit:**

- **Për investimet deri në 1,400,000 lekë,** ju lutemi përdorni **formularin model të Planit të Biznesit** ofruar në **Aneksin 2.1**, i cili konsiston vetëm në një Plan Biznesi të thjeshtë pershkruar / narrativ;
- **Për investime mbi 1,400,000 lekë,** ju lutemi përdorni **formularin model të Planit të Biznesit** ofruar në **Aneksin 2.2**, i cili konsiston në dy pjesë një narrative dhe një financiare:
  - **Pjesa narrative** e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në **Aneksin 2.2.1** dhe duhet të dorëzohet e printuar në letër në versionin origjinal;
  - **Pjesa Financiare** e Planit të Biznesit duhet të përgatitet duke përdorur modelin e dhënë në **Aneksin 2.2.2** dhe duhet të dorëzohet në versionin e printuar dhe në atë elektronik (CD-Rom) per arsyen sepse (ilogaritjet e bëra në versionin elektronik të pjesës financiare të Planit të Biznesit dërguar në CD-ROM do të verifikohen).

Ju lutemi qe te përgatitet një BP sa me i plete ndiqni me kujdes udhezimet mbi përgatitjen e BP qe jepen ne Aneksin 2.3 te UpA.

**(c) Të gjitha dokumentet mbështetëse,** që kërkojnë në formularin e Aplikimit (shih Aneksin 1 të Udhëzuesit për Aplikantët)

- Aplikanti duhet të dorëzojë në dosjen e aplikimit se bashku me formularin e aplikimit edhe të gjitha dokumentet mbështetëse, që kërkojnë dhe që paraqiten në listën e Pjesen e 5 të Formularit të Aplikimit (Aneksi 1 i UpA), si provë për të vërtetuar se ai apo ajo i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë që lidhen me investimin.
- Në rastin kur Formulari i Aplikimit kërkon “Kopje” të dokumenteve, keto kopje te dokumentave duhet te jene te lexueshme qarte dhe lehtesishët dhe identike me origjinalet dhe aplikanti duhet te konfirmoje kete nepermjet vetedeklarimit qe percaktohet ne formularin e aplikimit. Me kete aplikanti merr persiper perjegjesine mbi vertetesine e dokumentave te dorezuar.
- Aplikanti duhet të ruajë një dosje per vehten e tij në fermën /stabilimentin e tij ku ruan edhe të gjitha dokumentet origjinale. Ne kete dosje ai ruan edhe origjinalet e dokumentave qe ka dorezuar si fotokpje, sepse ato do të kerkohen dhe krahasohen me kopjet e dorezuara per te vërtetuar originalitetin e kopjes gjatë kontrollit në vend (qe do te ushtrohet ne ferme apo stabiliment). Në rast te mospërputhjes te dokumentave te dorezuar si kopje me origjinalin aplikimi mund te refuzohet ose perkatesisht do të refuzohet pagesa përkatëse për grantin. Dokumentat origjinale duhet te permbajne te gjithe elementet qe kerkon legjislacioni shqiptar (si psh vula, nenshkrimi, protokollin etj)
- **Së bashku me formularin e Aplikimit, aplikantët duhet të paraqesin edhe dokumentat e mëposhtëm;**
  - A. 3 oferta origjinale për çdo shpenzim që lidhet me projektin e investimit dhe që është më i lartë se sa 140,000 Lek (Vlera totale e fatureve).

B. *Ne rastin kur aplikuesi ka kryer pagesa qe lidhen m blerjen e sherbimeve nen kategorine “kosto te per gjithshme” aplikuesi dorezon si vijon;*

1. *Ne rastin kur vlera totale e fatures nuk e kalon vleren 1,400,000 Lek aplikuesi dorezon vetem faturën origjinale leshuar nga ofruesi i sherbimeve sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar.*
2. *Ne rastin kur vlera totale e fatures e kalon vleren 1,400,000 Lek aplikuesi dorezon*
  - i. *Kontraten e nenshkruar ndermjet tij dhe ofruesit te sherbimit si edhe*
  - ii. *faturën origjinale leshuar nga ofruesi i sherbimeve sipas kerkesave te legjislacionit shqiptar.*

**Kërkesat në lidhje me ofertat janë si më poshtë:**

Të trija ofertat duhet të janë lehtësishët të krahasueshme, për këtë arsy

- a. Aplikuesi kerkon 3 oferta nga 3 furnitore te ndryshem mbi bazen e kerkeses të bazuar në të njëjtat specifime teknike për çdo mall/shërbim.
- b. Aplikuesi per kete per gatit specifikimet teknike neutrale per sejcilin ze te investimit per te cilin ai aplikon tek SARED si vijon;
  - i. Ne rastin e investimeve ne paisje, makineri, mekanizim ofertat duhet te permbajne elementet si psh tipi, modeli, kapaciteti/fuqia e motorrit si edhe karakteristika te tjera thelbesore per paisjen/maknerine) si psh ne rastin e traktorit tipi dhe modeli i motorrit, madhesia e gomave, Nr shasise etj)
  - ii. Dhe ne rastin investimit ne ndertim / rikonstrukcion oferta duhet të bazohet mbi të njëtin preventiv ose specifime teknike, te permbaje sasite etj.

Ofertat / faturat nga furnitoret e huaj duhet te kerkohen dhe te leshohen mundesisht ne gjuhen angleze. Aplikuesi duhet t'i bashkengjise dokumentave origjinale nje perkthim zyrtar.

Ofertat / faturat nga furnitoret ne Shqiperi duhet te leshohen ne gjuhen Shqipe dhe ne monedhen Shqiptare (Lek).

Furnitoreve nga Shqiperia iu kerkohet te dergojne se bashku me ofertat ekstraktine thjeshte te rregjistrimit nga QKR. Furnitorët / ofruesit e sherbimeve te cilet janë ftuar te paraqitin tre oferta për të gjitha shpenzimet qe lidhen me investimin dhe qe jane ne vleren mbi 140,000 lekë, nuk duhet te kene lidhje farefisnore dhe ose biznesi me njeri tjetri apo me aplikantin (me lidhje farefisnore ketu kuptohen anetaret e ngushte te familjes dhe me ekzakt Bashkeshorti, Bashkeshortja, Babai, Nena, Vellai, Motra, Kunati, Kunata).

Furnitoreve nga jashte Shqiperise iu kerkohet qe ne oferte, pervec elementeve themelore qe duhet te permbaje oferta e tyre sic kerkohet ne paragrafin me poshte, te bejne nje deklarim me permbajtjen si vijon;

- Kompania ofertuese ka nje biznes ne status aktiv ne fushen e biznesit qe lidhet me oferten,
- Kompania nuk ka lidhje familjare (si ne paragrafin me lart qe i referohet furnitoreve nga Shqiperia) apo
- Lidhje biznesi me kerkuesin e ofertes (aplikantin),

Ne rastin kur verifikohen lidhjet e pershkruara me lart ndermjet aplikuesit dhe njerit nga ofertuesit apo perfaqesuesit ligjor te tij atehere kerkohet nje oferte e re.

Nese aplikuesi nuk dorezon dokumentat e kerkuar brenda afateve atehere aplikimi i tij do te refuzohet.

Elementet kryesore që kërkohen te permbahen në formatin e ofertave paraqiten më poshtë:

- Data e lëshimit
- Emri i furnitorit;
- Numri i regjistrimit të furnitorit ne QKR;

- Çmimi, TVSH-ja dhe taksa të tjera të paraqitura veç e veç dhe bazuar ne;
  - Specifikimet e detajuara teknike qe ka derguar aplikanti duke shtuar edhe specifikime te tjera specifike si tipi, modeli etj;
  - Në rast punimesh ndertimi apo mbjelljesh etj preventivi me çmimin për njësi;
  - Vendin e dorezimit te mallit
- Vlefshmëria e ofertës; e cila duhet te mbuloje te gjithe periudhen e investimit
- Nenshkrimi i ofertuesit apo perfaquesuesit te tij ligor dhe vulen aty ku eshte e aplikueshme

Ofertat duhet te jene ne origjinal dhe te vlefshme per kohen kur planifikohet te kryhet investimi.

Ne rast se ndonje nga ofertat e paraqitura eshte e fallsifikuar me qellim te perfitimeve te pamerituara nje aplikim i tille duhet te refuzohet.

Aplikanti ben krahasimin e tre ofertave bazuar ne tabelen e perfshire ne pjesen pershkruese (narrative) te biznes panit (shih tabelen per krahasimin e ofertave tek Biznes plani aneksi 2.1 dhe 2.2.1).

Nëse nuk zgjidhet oferta me vleren më te ulët/ekonomike, aplikanti duhet të japë një arsyetim/justifikim te shkruar për këtë zgjedhje e cila do vleresohet nga GIZ.

Ne tabelen e krahasimit te ofertave të gjitha vlerat në oferta apo fatura duhet të shenohen në Lek apo te perllogariten nga valute e huaj në Lek. Për ato oferta/fatura që lëshohen në valute te huaj nga furnitorët/kompanitë e huaja, llogaritja e vlerave nga monedha e huaj në lekë qe perfshihet ne kontrate bëhet me kursin e këmbimit të muajit në të cilin është hapur thirrja për aplikime ose në ne rastin e Kërkjesës për Pagesë llogaritja behet mbi bazen e kursit te kembimit të muajit në të cilin dorëzohet Kërkesa për Pagesë.

Shumat korrekte per te cilat behet aplikimi per kontraktim apo per kerkesen per pagese aplikuesi duhet t'i paraqese ne tabelen perkatese te dhene ne formularin e aplikimit dhe ose formatin e kerkeses per pagese.

Aplikanti duhet te perdore per perllogaritjet kursin e këmbimit qe gjendet në këtë adresë:

[http://ec.europa.eu/budget/contracts\\_grants/info\\_contracts/inforeuro/inforeuro\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/inforeuro/inforeuro_en.cfm)

### 5.3 Procedura për Dorëzimin e Aplikimeve

Dosjet e aplikimit duhet të dorëzohen në zyrat rajonale përkatëse të SARED dhe MBZHRAU-së në secilin prej qarqeve që mbulon skema e granteve SARED, dorazi dhe personalisht.

Do te pranohen vetem aplikimet qe dorezohen ne perputhje me afatet e thirrjes perkatese te shpallura ne njoftimin per Thirrjen per Aplikime te publikuar.

Aplikuesit e pranueshem sipas pikes 2.2.2 te UpA qe e kane stabilimentin e tyre (grumbullim / perpunim) jashte territorit te 6 qarqeve te pranueshem e dorezojne aplikimin ne zyren e qarkut ku ata blejne sasine me te madhe te produktit bujqesor lende e pare per perpunim / tregtim.

Dosjet e Aplikimit duhet të dorëzohen në një zarf te mbyllur, ne dy kopje me te njejta dokumenta (1 dosje originale dhe 1 dosje me te gjithe dokumentat e fotokopjuar). Dokumentat duhet te jene te renditur sipas radhes qe percaktohet ne Pjesen 5 te formularit te aplikimit "Lista e dokumentave mbeshtetes/shoqerues". Mbi zarf aplikanti duhet të shkruajë emrin dhe adresën e tij të plotë (kontaktet), titullin e projektit (investimit) dhe Zinxhirin e Vleres.

Ne kuader te skemes se granteve SARED, nje aplikant mund te paraqese maksimumi vetem 2 aplikime te suksesshme.

Por ai nuk lejohet te paraqese 2 aplikimet ne te njejten kohe.

Aplikanti mund te paraqese aplikimin e dyte nese ai apo ajo ka permbyllur me sukses kontraten e pare per grant dhe ka marre pagesen e grantit per investimin e bere ne kuader te kontrates se pare.

Autoriteti Kontraktues (GIZ) ruan pronësinë e të gjitha aplikimeve të marra. Rrjedhimisht, aplikantët nuk kanë asnë të drejtë që të kërkojnë t'u kthehen aplikimet origjinale.

#### 5.4 Renditja e Aplikimeve

Në këtë skemë nuk do të përdoret asnë lloj renditjeje e caktuar e kandidatëve (*ranking*), pasi këtu do të ndiqet rregulli “Atij që vjen i pari, i shërbehet i pari”. Ne rast se ky rregull do te ndryshoje aplikantet do te njoftohen paraprakisht.

### 6. Shënime të rëndësishme në lidhje me pranueshmërinë/refuzimin e Aplikimeve

Në qoftë se disa prej kërkesave formale të përcaktuara më sipër nuk respektohen plotësisht, reagimi do të jetë proporcional në raport me gabimet e identikuara dhe nuk do të ndikojë në trajtimin e barabartë të aplikantëve potencialë.

#### 6.1 Refuzimi për gabime madhore

Aplikimi **do të refuzohet** pa kërkuar dërgimin/ridërgimin e dokumenteve në rast të gabimeve së mëposhtme madhore:

- Dorëzimi i aplikimit pas afateve te njoftuar apo pas përfundimit të fondeve të skemës së granteve SARED
- Mosparaqitja e formularit të aplikimit;
- Mosdorëzimi i planit të biznesit;
- Mospërdorimi i modelit standard të formularit të aplikimit apo planit të biznesit;
- Plotësimi me shkrim dore i formularit të Aplikimit apo planit të biznesit;
- Moshoqërimi i formularit të Aplikimit me dokumente mbështetëse;
- Mosparaqitja e ofertave;
- Dorëzimi nga i njëjtë aplikant i dy aplikimeve në të njëjtën kohë në përgjigje të thirrjes për propozime.
- Aplikanti ka aplikime që nuk janë paguar ende;
- Aplikanti ka marrë që më përpara numrin / sasine maksimale të mbështetjes (i cili per skemen e Granteve SARED eshte 2 aplikime – shih 5.1);
- Aplikanti figuron debitor ndaj MBZHRAU-t;
- Investimi nuk është në përputhje me Listën e shpenzimeve të pranueshme (Aneksi 3).

#### 6.2 Ridorëzimi i dokumenteve për gabime të vogla

Në rastet e gabimeve të vogla paraqitur më poshtë, do të kërkohen **sqarime/ridërgimi i dokumenteve që mungojnë**:

- Formulari i Aplikimit dhe pjesa Narrative e Planit të Biznesit është paraqitur sipas modelit korrekt dhe është ofruar informacioni i kërkuar, por mënyra në të cilën është plotesuar dokumenti nuk është e qartë ose mungojnë disa të dhëna;
- Formulari i aplikimit/deklarata apo ndonje dokument tjeter nuk është firmosur ose përmban një firmë të skanuar.
- Një pjesë e dokumenteve mbështetëse mungojnë;
- Një dokument (psh certifikata, oferta, etj.) qe i ka mbaruar afati i vlefshmërisë;
- Totali i kostove të pranueshme është më i ulët ose më i lartë sesa limiti i dhënë në lidhje me llojin e investimit ne Udhëzuesin për Aplikantët;

**Para nënshkrimi të kontratës siç parashikohet në Udhëzuesin për Aplikantët, do të bëhen korrigjimet e mëposhtme:**

- Është ofruar informacioni i kërkuar në formularin e aplikimit dhe në pjesën narrative të planit të biznesit, por dokumentet nuk janë plotësuar në mënyrë korrekte, p.sh. informacioni është ofruar në seksionin X të formularit model, ndërkohë që duhet të ofrohej në seksionin Y;
- Korrigohen gabimet aritmetike;
- Hiqen zërat / kostot e papranueshme (të buxhetit);
- Nëse janë tejkaluar kufijtë e kostove të përgjithshme apo të planit të biznesit, kostot reduktohen;
- Korigohet nese aplikanti kërkon një sasi (%) më të lartë granti sesa eshte percaktuar ne Udhezuesin per Aplikantin ne lidhje me llojin e investimit.

### **6.3 Raste të tjera**

**Në të gjitha rastet e tjera që nuk parashikohen shprehimisht më sipër, MBZHRAU dhe GIZ do të marrin vendim rast pas rasti, duke garantuar që vendimi të respektojë**

- Parimin e trajtimit te barabartë të aplikuesve
- Parimin e proporcionalitetit.

Aplikantit do t'i jepet deri në 20 ditë pune afat për të dërguar dokumentet që mungojnë dhe nëse dokumentet nuk dërgohen brenda këtij afati apo dërgohen të paplota, aplikimi nuk do të pranohet.

## **7. Kontrolllet në vend**

### **7.1 Kontrolli në Vend para kontraktimit**

Aplikimet që janë në përputhje me rregullat administrative dhe të pranueshmërisë do të verifikohen në terren për të parë nëse informacioni i paraqitur në formularin e aplikimit është korrekt.

Kontrolli në Vend do të kryhet nga koordinatorët rajonalë të GIZ-it dhe stafi i MBZHRAU-t në qarqe (stafin e ekstensionit, etj.) dhe sipas nevojes nga Autoritetet Kombëtare dhe ekspertët afat-shkurtër të kontraktuar nga GIZ-i në fushat përkatëse të investimit, të cilët do të verifikojnë informationin e lidhur me pranueshmerine dhe përbushjen e standardeve kombëtare minimale të projektit të planifikuar të investimit.

Kontrolli në Vend para kontraktimit bëhet vetëm për investimet në ndërtim, rindërtim dhe mbjellje/rimbjellje (jo për makineri dhe pajisje të reja të lëvizshme si p.sh. traktori, pompa spërkatëse, etj.) si edhe ne cdo rast investimi per te cilin Autoriteti kontraktues vendos se eshte i nevojshem te kryhet. Gjatë kontolleve në terren do të kontrollohen dokumentet origjinale dhe asetet.

Në qoftë se nga kontrollet në vend konstatohet se aplikanti apo projekti i investimit nuk përbush kriteret e pranueshmërisë që përcaktohen në Udhëzuesin për Aplikantët, aplikimi do të refuzohet edhe mbi vetëm këtë bazë.

### **7.2 Kontrolli në Vend para pagesës**

Kërkesat për Pagesë që janë në përputhje me rregullat administrative dhe ato të pranueshmërisë do të kontrollohen në vend për të verifikuar nëse informacioni i paraqitur në formularin e kerkeses per pagesë është korrekt.

Kontrolli në Vend do të kryhet nga koordinatorët rajonalë të GIZ dhe stafi i MBZHRAU-t në qarqe (stafin e ekstensionit, etj) dhe sipas nevojes nga Autoritetet Kombëtare dhe nga ekspertët afatshkurtër të kontraktuar nga GIZ në fushën përkatëse të investimit, duke verifikuar standardet kombëtare minimale të projektit të planifikuar të investimit.

Kontrolli në Vend para pagesës do të bëhet në 100% të aplikimeve per te kontrolluar qe investimi eshte kryer ne perputhje me kontraten dhe eshte vene ne funksionim si dhe nese pagesat e furnitoreve jane kryer.

Gjatë kontrolleve në vend do të kontrollohen dokumentet origjinale dhe asetat dhe kontrolluesi(t) mund të bëjë fotografi, të masë parcelat e tokës, ndërtesat, etj. Kontrollori mund të mbajë gjithashtu shënime dhe të mbledhë çdo provë tjetër që mund të mbështesë përgjigjet e dhëna në listën e kontrollit.

Në bazë të Kraportit te Kontrollit në Vend dhe konstatimit të perputhshmerise me kontraten kerkesa per pagesen e grantit miratohet. Ne rast te konstatimi te mospërputhjeve me kontraten, Kërkesa për Pagesë refuzohet ose rishikohet (korrigjime në llogaritjen e shumave të këruara).

## **8. Njoftimi i Aplikantëve në lidhje me marrjen e vendimit**

Aplikantët do të informohen me shkrim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues në lidhje me aplikimin e tyre;

Në rast vlerësimi/vendimi pozitiv, aplikanti do të ftohet që të nënshkruajë konratën, kurse në rast refuzimi, Autoriteti Kontraktues (GIZ) i informon ata mbi arsyet e vendimit negativ.

## **9. Ankesat**

Aplikantët që besojnë se mund të janë dëmtuar nga një gabim apo një parregullsi gjatë procesit të vlerësimit, mund të paraqesin një ankesë brenda 15 ditë pune nga data e marrjes së vendimit. Ankesa duhet të paraqitet me shkrim në zyrat rajonale ose direkt me postë në zyrën kryesore në Tiranë, firmosur nga aplikanti dhe duke iu referuar arsyetimit të vendimit të marrë nga Autoriteti Kontraktues. Pas rivlerësimit të situatës për të cilën është paraqitur një ankesë, Autoriteti Kontraktues do të lëshoje një përgjigje me shkrim.

## **10. Kontrata për dhënien e grantit**

Pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënien e grantit, përfituesit do t'i ofrohet kontrata e grantit. Në mënyrë që aplikantët të familjarizohen me përbajtjen e Kontratës së Grantit, Autoriteti Kontraktues do të vërë në dispozicion për ta një model të Kontratës së Grantit online në faqen e internetit të MBZHRAU-t [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al).

Përfituesi potencial do të marrë një Njoftim për Vendimin për Dhënien e Grantit, përmes të cilit Përfituesi do të ftohet për të ardhur dhe për të firmosur Konratën brenda një periudhe 10 dite pune nga data në të cilën dërgohet njoftimi nga zyra qendrore.

Kontrata e Grantit do të lëshohet në dy kopje në secilën gjuhë (anglisht dhe shqip), një kopje për Autoritetin Kontraktues (GIZ) dhe kopja tjeter për Përfituesin e Grantit.

Me firmosjen e Kontratës së Grantit, aplikanti deklaron se, nëse i jepet një grant, ai pranon kushtet kontraktuale të parashikuara në Konratën e Grantit.

Koha maksimale për përgatitjen e kontratës është deri në 2 muaj pas datës së paraqitjes së dosjes së plotë të aplikimit.

## **11. Vizibiliteti i investimit dhe kontrolllet pas financimit**

Përfituesi i Grantit është i detyruar që menjëherë pas bërjes së pagesës, në përputhje me masën e investimit të financuar, të vendosë një *logo/plakë shpjeguese* ku thuhet se Projekti i Investimit është financuar nga: Programi Gjermano-Danez “Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik Rural në Zonat e Pafavorizuara në Shqipëri” – SARED. Logoja/plaka do të prodhohet dhe dërgohet në vend nga Autoriteti Kontraktues GIZ.

## **12. Miratimi për Pagesën e Grantit – Kryerja e Pagesës**

Pas përfundimit të investimit sipas kontratës, Përfituesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues dosjen e Kërkësës për Pagesë.

Dosja e kerkeses per pagesen e grantit duhet te dorezohet ne zyrat perkatese dorazi, sipas modelit zyrtar te formularit te Kérkesës për Pagesë (shih Aneksin 5 te UpA). Edhe dosja e kerkeses per pagese (njelloj si ne rastin e dosjes e aplikimit per kontraktim) duhet te dorezohet ne dy kopje dhe te gjithe dokumentat duhet te jene te renditur sipas radhes qe mbajne ne pjesen 5 te formularit te kerkeses per pagese "Lista e dokumentave mbeshtetes", 2 Dosjet duhet te dorezohet dorazi dhe personalisht dhe ne nje zarf te myllur.

### **12.1 Dosjen e kérkesës për pagesë permban;**

- a) Formularin e plotesuar te Kerkeses per pagese qe shkarkohet nga faqja e internetit e MBZHRAU, Kerkesa per pagese nuk duhet te plotesohe me dore.
- b) Të gjitha dokumentet e kérkuara mbështetëse si pjesë të formularit te kérkesës për pagesë
- c) Të gjitha faturat origjinale për sejcilen nga shpenzimet dhe pagesat me transferta bankare të bera per furnitorët. Të gjitha pagesat duhet të bëhen me transferta bankare nga llogaria e përfituesit në llogarinë e furnitorit dhe kjo duhet të vërtetohet me deklaratën bankare të datës kur bëhet transferta.
- d) Duhet te paraqitet brenda afateve kohore te percaktuar ne kontraten individuale te nenshkruar me GIZ
- e) Ne kerkesen per pagese te gjitha vlerat e shpenzimeve duhet te jepem ne Lek. Perlogaritja nga monedhat e huaja ne Lek bazohet ne kursin e kembimit qe gjendet ne adresen;  
[http://ec.europa.eu/budget/contracts\\_grants/info\\_contracts/inforeuro/inforeuro\\_en.cfm](http://ec.europa.eu/budget/contracts_grants/info_contracts/inforeuro/inforeuro_en.cfm)
- f) Faturat nga furnitoret e huaj duhet te kerkohen te leshohen mundesisht ne gjuhen angleze ose ne shqip dhe aplikuesi i bashkengjit dokumentave origjinale perkthimin zyrtar ne gjuhen Shqipe.
- g) Faturat duhet te jene aritmetikisht korrekte,
- h) Vlerat ne fature, njesite dhe specifikimet teknike duhet te perputhen me me kontraten e nenshkruar ndermjet aplikantit dhe autoritetit kontraktues,
- i) Te gjitha shpenzimet, pervec kostove te perjithshme, duhen bere pas dates se nenshkrimit te kontrates me GIZ. Kostot per investimet e kryera me pare nenshkrimit te kontrates dhe kostot jashte shpenzimeve te parashikuara ne kontrate nuk jane te pranueshme.
- j) Pagesat cash nuk pranohen. Te gjitha pagesat e paraqitura me kerkesen per pagese duhet te jene kryer nepermjet transfertave bankare nga llogaria bankare e përfituesit ne llogarine bankare te furnitorit. Kerkohet te dorezohet nga aplikanti deklarata bankare "bank statement" per te vertetuar informacionin.
- k) GIZ ka pronesine e dokumentave te dorezuar me kerkesen per pagesen. Përfituesve te grantit nuk u kthehen faturat origjinale te pagesave (perjashtim behet kur faturat origjinale jane vulosur me vulen e GIZ).
- l) Ne rastin kur ne formularin e kerkeses per pagese kerkohet te paraqiten forokopje te dokumentave ato duhet te jene te qarta te lexueshme lethesisht dhe identike me originalin dhe kjo gje konfirmohet nepermjet deklarimit nga aplikuesi ne formatin e kerkeses per pagese. Nepermjet kesaj aplikanti merr perjegjesine mbi vertetesine e dokumentave te dorezuar.

### **12.2 Kryerja e pageses**

Pas miratimit te kerkeses per pagesen, GIZ transferon vleren e grantit ne llogarine bankare te përfituesit e cila eshte dhene ne formularin e aplikimit.

Aplikuesi mund te kerkoje vetem me shkrim ndryshimin e numrit te llogarise qe ka dhene ne formularin e aplikimit.

Granti do të transferohet nga zyra qendrore e GIZ-it në llogarinë bankare të përfituesit te grantit në bazë të autorizimit të pagesës dhe urdherit të ekzekutimit të pagesës.

Koha maksimale për ekzekutimin e pagesës në llogarinë e përfituesit është deri në dy muaj pas datës së paraqitjes së dosjes së plotë të Kërkesës për Pagesë.

### 13. Përbledhje e disa Shënimave të Rëndësishme për Aplikantët

- Aplikimet mund të përfshijnë vetëm investime në aktive të luajtshme dhe të paluajtshme siç përshkruhet në Aneksin 3 “**Lista e Shpenzimeve të Pranueshme**” të Udhëzuesit për Aplikantët.
  - Të gjitha makineritë dhe pajisjet e blera **duhet të janë të reja**.
  - Skema e grantit mbështet vetëm investimet që do të zbatohen **pas nënshkrimit të Kontratës së Grantit**.
  - **Investimet** që janë ekzekutuar në të kaluarën ose që kanë filluar të zbatohen para nënshkrimit të Kontratës së Grantit **nuk janë të pranueshme** në këtë Skemë Grantesha.
  - **Vetëm pagesat që lidhen me kostot e përgjithshme** (shih pikën 3.1 më lart), që janë realizuar para dërgimit të aplikimit dhe që janë bërë në lidhje me aktivitetet e nevojshme për përgatitjet e projektit të investimit dhe aplikimit janë të pranueshme (konsulentët, përgatitja e planeve të biznesit, projektet teknike, formulari i aplikimit, etj.).
  - Të gjitha **investimet duhet të janë në përputhje me standarde minimale kombëtare përkatëse** në lidhje me mbrojtjen mjedisore, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve dhe sigurinë në punë. Kjo mund të kontrollohet gjatë kontolleve në vend para lidhjes së kontratës dhe para autorizimit të pagesës nga organet/autoritetet përkatëse që janë në varësi të MBZHRAU-t (Shërbimi Kombëtar Veterinar, Autoriteti Kombëtar për Farat dhe Fidanët dhe/ose Autoriteti Kombëtar i Ushqimit) së bashku me ekspertët e SARED në bazë të formularëve model të raporteve të konfirmimit që përdoren zyrtarisht nga këto organe/autoritete.
- Autoritet përkatëse do të kontrollojnë, gjithashtu, nëse sa më poshtë kanë lidhje me investimin:
- Ndërtesa/godina që është ndërtuar/rikonstruktuar; dhe/ose
  - Ndërtesa/godina ku është instaluar pajisja e sapoblerë; dhe/ose
  - Trualli ku është bërë investimi.
- Në rast **ndërtimi dhe/ose rikonstruksioni**, aplikanti dhe furnitori i punimeve / shërbimeve duhet të përgatisë dhe të mbajë të gjithë dokumentacionin teknik si projektet e ndërtimit/rikonstrukcionit, duke përfshirë edhe dokumentet e tjera relevante siç i kërkon ligji shqiptar dhe këto duhet të dorëzohen së bashku me kërkesën për pagesë siç përcaktohet në Udhëzuesin për Aplikantët.
  - Për të qenë të pranueshme për mbështetje, projektet e investimit që propozohen duhet të janë **ekonomikisht të qëndrueshme**. Qëndrueshmëria ekonomike tregohet përmes planit të biznesit. Për investimet/shpenzimet e pranueshme totale deri me 1,400,000 lekë, aplikanti duhet të përgatisë dhe të dorëzojë versionin e thjeshtuar të planit të biznesit dhënë në Aneksin 2.1. Aplikanti me shpenzime të pranueshme totale mbi 1,400,000 Lek duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një **plan biznesi** duke përdorur modelin e dhënë në Aneksin 2.2, i cili duhet të demonstrojë qëndrueshmërinë ekonomike të fermës në fund të realizimit të projektit.
  - Të gjitha pagesat në lidhje me investimet/blerjet duhet të bëhen me transferim bankar nga llogaria bankare e aplikantit në llogarinë bankare të furnitorit të shërbimeve ose mallrave në bazë të faturave sipas formatit zyrtar siç e kërkon ligji përofuesit/furnitorët e regjistruar të shërbimeve.
  - Kontratat me furnitorët e shërbimeve, makinerive, dhe të punimeve të ndërtimit se bashku me faturat origjinale duhet të dorëzohen bashkë me formularin përkatës të Kërkesës për Pagesë dhe këto duhet të janë firmosur brenda periudhes te percaktuar ne kontraten e Grantit te nenshkuar midis aplikantit dhe nëpunësit autorizues të GIZ-it.
  - Afatet e përcaktuara në Udhëzuesin për Aplikantët për finalizimin e investimeve në kontratën individuale për dorëzimin e Kërkesës për Pagesë duhet të respektohen. Shpenzimet dhe Kërkesa për Pagesë të paraqitura pas këtyre afateve do të konsiderohen të papranueshme.

**Anekset:**

**1. Formulari i Aplikimit**

**2. Plani i Biznesit**

2.1 Plan Biznesi për Investime deri në 1,400,000 Lek

2.2 Plan Biznesi per Investime mbi 1,400,000 Lek

2.2.1 Plan Biznesi për Investime mbi 1,400,000 Lek – pjesa narrative/përshkruese

2.2.2 Pjesa financiare e Planit të Biznesit për Investime mbi 1,400,000 lekë

2.3 Udhëzime për Aplikantët mbi mënyrën e plotësimit të Planit të Biznesit

**3. Lista e Shpenzimeve të Pranueshme**

**4. Lista e Frutave dhe BAM-eve Pranueshme**

**5. Kërkesa për Pagesë**